

Dr. Florida DOBI

Drejtor i Qendrës Kombëtare Terapeutike dhe Rehabilituese për Fëmijët

Doktore e shkencave që nga viti 2016, është një psikiatre për fëmijë dhe adoleshentë me mbi 20 vjet eksperiencë në aktivitetin klinik dhe e specializuar në neuropsikiatri infantile në Institutin Kombëtar të Neurologjisë “Carlo Besta”, Milano, Itali. Anëtare e grupeve të punës për hartimin e politikave në “Shëndetin mendor”, si dhe për hartimin e udhërrëfyesve dhe protokolleve të trajtimit të çrregullimeve mendore, Ministria e Shëndetësisë. Autore dhe bashkëautore e publikimeve në revista shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare. Bashkëautore e tekstit: “Bazat e Psikiatrisë, për studentët e Infermierisë”. Prej vitit 2004, lektore e lëndëve të Neuroshkencave pranë Universitetit të Shkencave Mjekësore e Teknike të Tiranës në Degën e Logopedisë. Ka drejtuar Qendrën Komunitare të Shëndetit Mendor Nr.1, Tiranë për 13 vjet. Prej 2019 e në vijim, Drejtore e Qendrës Kombëtare të Mirërritjes, Zhvillimit dhe Rehabilitimit të Fëmijës, Tiranë, sot Qendra terapeutike dhe Rehabilituese për Fëmijët.

Disa nga detyrat dhe kompetencat e Drejtorit të Qendrës Kombëtare Terapeutike dhe Rehabilituese për Fëmijët, janë si më poshtë:

Titullari ekzekutiv, drejtues, organizues dhe kontrollues i gjithë aktivitetit të institucionit bazohet në strategjinë e Ministrisë së Shëndetësisë për të përcaktuar objektivat strategjike për përmirësimin e aksesit dhe cilësinë e shërbimit shëndetësor.

Drejtori përgjigjet për aktivitetin e Qendrës para Ministrit të Shëndetësisë

Drejtori i Qendrës i propozon Ministrit të Shëndetësisë për miratim emërimin dhe lirim nga detyra të Zëvendës drejtorit dhe Shefit të Shërbimit, emëron personelin sipas kriterëve të punësimit dhe vlerësimit të pozicionit të punës, merr vendime për largim nga puna apo dhënia e masave disiplinore kur shkelet Kodi i Punës apo Rregullorja e Brendshme e QKTRF.

Harton planin e punës në fillim të vitit, organizon dhe drejton mbledhjet e Drejtorisë së Qendrës në bazë të një tematike të përcaktuar

Koordinon lidhjen ndërmjet QKTRF-së dhe pushtetit vendor si dhe homologëve të tij brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë.

Organizon, drejton dhe analizon të gjitha problemet teknike-ekonomike dhe financiare të QKTRF-së si dhe ndjek realizimin e të gjithë treguesve të gjëndjes së institucionit.

Organizon kontrole për aktivitetet dhe shërbimet mjekësore dhe jomjekësore dhe merr vendimet përkatëse për përmirësimin e gjëndjes.

Drejton dhe organizon punën për njohjen e akteve ligjore dhe nënligjore dhe kontrollon zbatimin e tyre. Kërkon nga drejtuesit dhe nga gjithë personeli i institucionit zbatimin me rreptësi të ligjeve në fuqi, disiplinës në punë dhe kryerjen në kohë dhe me cilësi të detyrës.

Drejton punën për hartimin e projekt-buxhetit ekonomik dhe financiar, miraton buxhetin e zbërthyer për çdo shërbim dhe repart, miraton programin e buxhetit në të gjitha zërat e tij, kontrollon punën dhe përgjigjet për plotësimin ritmik të harxhimit të buxhetit në të gjitha zërat.

Organizon punën për shqyrtimin dhe zgjidhjen në kohë të kërkesave dhe ankesave të punonjësve, përmirësimin e kushteve të punës të punonjësve dhe kushteve të kujdesit të fëmijëve, kërkon zbatimin e rregullave të sigurimit teknik, higjeno-shëndetësor dhe të mbrojtjes kundër zjarrit për çdo shërbim dhe repart.

Drejton dhe organizon aktivitetet në kuadrin e marrëdhënieve publike për promocionin e shëndetit mendor dhe zhvillimin e fëmijëve.

Organizon, drejton dhe kontrollon nivelin e kualifikimeve të personelit të lartë dhe të mesëm sipas një plani të veçantë.

Udhëheq, organizon dhe forcon bashkëpunimin interdisiplinar brenda stafit.

Organizon, drejton dhe ndjek të gjithë punën për kryerjen e studimeve shkencore, konferencave, sesioneve dhe trajnimeve brenda dhe jashtë institucionit, sipas një plani të përcaktuar.